



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 513, datë 25.9.2025

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE
TË MINISTRISË SË MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Ministria e Mjedisit ka si mision hartimin e zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen nga ndryshimet klimatike, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave.
3. Ministria e Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha përgjegjësie shtetërore:
 - a) Sektori i mjedisit, përfshirë politikën, standardet e trajtimit dhe infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve, si dhe monitorimin e kontrollin e efekteve, që sjellin në drejtim të ajrit e të mjedisit, cilësinë e ajrit, ndotjen industriale kimikate, monitorimin e efekteve klimatike, monitorimin e kontrollit të treguesve të mjedisit e të cilësisë së ujërave, vlerësimin e ndikimit në mjedis;
 - b) Natyra dhe biodiversiteti, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura;


c) Sektori i pyjeve dhe i kullotave.

4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

A large, stylized handwritten signature in dark ink, consisting of several overlapping loops and a long horizontal stroke, is written over the printed name 'EDI RAMA'.

NR.PROT. 4505/2
DATE 25.9.2025

KRYEMINISTRISË
MINISTRISË SË MJEDISIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

